

V E N D I M
Nr. 433, datë 4.8.2000

**PËR DHËNIEN E LIÇENSËS SË DYTË PËR TË NDËRTUAR RRJET PUBLIK
TELEKOMUNIKACIONESH DHE PËR TË OFRUAR SHËRBIME PUBLIKE TELEFONIKE
TË LËVIZSHME, TOKËSORE, SIPAS STANDARDIT GSM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 48 dhe 49 të ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000, “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit nr.288, datë 18.6.1999, “Për miratimin e Dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të fillojnë procedurat për dhënien e liçensës së dytë për të ndërtuar rrjet publik telekomunikacionesh dhe për të ofruar shërbime publike, telefonike të lëvizshme, tokësore sipas standardit GSM.
2. Operatori të përzgjidhet nëpërmjet tenderit të hapur ndërkombëtar. Kriteret dhe kushtet e dhënies së liçensës, si dhe procedurat e hapjes dhe të vlerësimit të ofertave miratohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.
3. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të realizojë me konsulencë ndërkombëtare procedurat e tenderit.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe Enti Kombëtar Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta